

MENDIM PAKICE

Unë, Genta Tafa (Bungo), komisionerja e mbetur në pakicë, mendoj se vlerësimi i provave dhe fakteve nuk është i bazuar në ligj, në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe standardin e Komisionit. Për këtë arsye, kam votuar për shkarkimin e subjektit Besnik Hoxha, bazuar në pikat 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Ky vlerësim imi bazohet në analizën e mëposhtme:

Godinë banimi trekatëshe, në Shkodër

1. Për këtë pasuri të deklaruar nga subjekti, në këndvështrimin tim, problematikat e konstatuara janë këto:

➤ *Në lidhje me mënyrën e fitimit të shtëpisë së banimit një kat, Shkodër, që ka shërbyer si baza e krijimit të shtëpisë trekatëshe*

Nga hetimi ka rezultuar se i ndjeri F.D ka ndërruar jetë në datën 1.8.1997. Familjarët e tij, pikërisht bashkëshortja, ka kërkuar çeljen e trashëgimisë ligjore pas 6 vjetësh, në vitin 2003.

2. Në datën 23.6.2003, subjekti ka shpallur vendimin për çeljen e dëshmisë së trashëgimisë për të ndjerin, vendim që ka marrë formë të prerë më 8.7.2003. Pikërisht një muaj më vonë, në datën 7.8.2003, subjekti ka blerë me kontratë shitblerjeje nr. *** shtëpinë e trashëguar me vendimin e shpallur prej tij.

3. Subjekti ka pretenduar se nuk ka pasur konflikt interesi në këtë marrëdhënie, madje as cenim të etikës, sepse, sipas tij: (i) vendimi gjyqësor nuk është ankimuar; (ii) Komisioni nuk ka përshkruar se cilën rregull etike ka shkelur specifikisht; (iii) sjellja etike e magjistratit është komponent i vlerësimit profesional.

4. Ndryshe nga sa ka vlerësuar shumica, unë mendoj se në këtë rast subjekti ka cenuar etikën në sjelljen e magjistratit jashtë sallës së gjykimit.

5. Të nënshkruash një kontratë shitblerjeje me një palë, për të cilën je shprehur në sallën e gjyqit një muaj më parë, të blesh nga kjo palë një shtëpi të trashëguar pikërisht për shkak të vendimit gjyqësor të shpallur nga magjistrati, palë në kontratën e shitblerjes, unë mendoj se në rastin më të mirë është cenim i etikës.

6. Nga ana tjetër, duket sikur kërkesa për çeljen e trashëgimisë 6 vjet pasi ka ndërruar jetë trashëgimlënësi dhe shitja e kësaj prone të trashëguar pikërisht tek gjyqtari që çel dëshminë e trashëgimisë menjëherë një muaj më pas, në rastin më të keq duket sikur veprimtaria gjyqësore ka pasur për qëllim pikërisht blerjen e shtëpisë nga magjistrati.

➤ *Në lidhje me ndërtimin e shtëpisë trekatëshe*

7. Në DPV-në e vitit 2003, subjekti ka deklaruar shtëpi për banim dykatëshe dhe shtesa e katit të parë dhe të dytë në proces ndërtimi. Vlera e deklaruar: 1,100,000 lekë.

8. Në DPV-në e vitit 2004, subjekti ka deklaruar shtesë në shtëpinë ekzistuese të banimit, kati i parë gjithsej 80 m² dhe kati i dytë 80 m². Shtesa është në procedurë regjistrimi. Vlera e deklaruar: 500,000 lekë.

9. Që nga viti 2004 e deri në vitin 2015, subjekti nuk ka deklaruar asgjë në lidhje me ecurinë e këtij ndërtimi dhe shpenzimet që ka kryer për ndërtimin.

10. Në DPV-në e vitit 2015, bashkëshortja e subjektit deklaroi se banesa me sipërfaqe 58 m², me vendndodhje në Shkodër, është deklaruar në vitin 2003 si banesë në ndërtim e sipër dhe me procedurë regjistrimi në vazhdim. Sipërfaqja e deklaruar 105.4 m², nga e cila 88.2 m² është ndërtesë (tre kate). Në këtë deklaram nuk ka asnjë të dhënë për vlerën e pasurisë apo shpenzimet e kryera për ndërtimin.

11. Në deklaratën *Vetting*, subjekti e ka deklaruar këtë pasuri si godinë banimi tre kate. Ai ka deklaruar se për periudhën 2003 – 2013 janë bërë investime mbi objektin në vlerën 5,007,548 lekë. Ai ka deklaruar gjithashtu vlerën 900,000 lekë për blerjen e banesës ekzistuese në vitin 2003.

12. Nga analiza e dokumentacionit, unë konstatoj se:

i) Subjekti ka fshehur ndërtimin e katit të tretë gjatë gjithë periudhës së deklaramit 2003 – 2015. Në asnjë deklaratë periodike nuk është përmendur ky kat dhe as shpenzimet për ndërtimin e tij.

Nga ortofotot e administruara duket qartë që kati i tretë ka qenë ekzistues që në vitin 2007. Vetë subjekti ka aplikuar për legalizimin e banesës trekatëshe në vitin 2013.

ii) Sipërfaqja e deklaruar nuk përputhet me dokumentacionin e administruar. Në vitin 2003, sipërfaqja nuk deklarohet fare. Në vitin 2004 deklarohet sipërfaqe kati i parë 80 m² dhe kati i dytë 80 m².

Ndërkohë, në vitin 2015 rezulton se kati i parë është 88.2 m² dhe dy katet e tjera janë nga 105.4 m².

Mungesa e një deklarami të saktë të sipërfaqes ndër vite, e shoqëruar me mungesë deklarami ndër vite, si dhe mungesë të dokumentacionit për shpenzimet e ndërtimit, krijojnë pengesa në përlllogaritjen totale të shpenzimeve të kryera nga subjekti për ndërtimin e kësaj pasurie. Kjo e vendos Komisionin në vështirësi për përlllogaritjen dhe kryerjen e një analize financiare për subjektin, ndërsa subjektin në kushtet e një mungese të bashkëpunimit të plotë.

iii) Subjekti ka deklaruar gjatë hetimit, por edhe në seancë, se shpenzimet e kryera prej tij për mobilimin e tre kateve të banimit kanë qenë në vlerën 300,000 lekë.

Në këndvështrimin tim, kjo gjë është në kufijtë e së pamundurës, për pasojë unë mendoj se kjo deklaratë e subjektit nuk është bindëse. Subjekti duket se është përpjekur të fshehë të vërtetën, të cilën mund ta kishte vërtetuar nëpërmjet fotove të kësaj banese, për të provuar të kundërtën. Qëllimi i kësaj deklarate është ulja maksimale e shpenzimeve, me qëllim arritjen e një rezultati pozitiv në analizën financiare.

iv) Për mënyrën e llogaritjes së shpenzimeve të ndërtimit, unë mendoj se këto shpenzime duhet të llogariten duke filluar nga muaji gusht 2003, kur subjekti ka blerë shtëpinë njëkatëshe dhe të shtrihen shpenzimet për shtesën e katit të parë dhe ndërtimin e katit të dytë deri në fund të vitit 2004, që përputhen edhe me deklarin e bërë nga subjekti në vitin 2004. Ndërsa shpenzimet për ndërtimin e katit të tretë duhet të shtrihen deri në vitin 2007, ku nga ortofotot duket se ka përfunduar ndërtimi.

13. Në një përlllogaritje të tillë, sipas analizës financiare, subjekti do të rezultonte përkatësisht:

- Në vitin 2003 në vlerë pozitive, por që nuk është deklaruar si gjendje *cash* në fund të vitit 2003.
- Në vitin 2004 në vlerë negative, në shumën 1,301,137 lekë.
- Ndërsa për vitet 2005 – 2007 për ndërtimin e katit të tretë rezulton me mungesë financiare në shumën 1,466,217 lekë.

14. Në përfundim për këtë pasuri, në vlerësimin tim, subjekti ka mungesë burimesh financiare në shumën 2,767,354 lekë, ka kryer deklarin të pasaktë ndër vite me qëllim fshehjen, qoftë edhe në mënyrë të pjesshme të pasurisë.

15. Për të qenë sa më ezaurues me pretendimet e subjektit, nëse do të merreshin në konsideratë, duke pranuar se shumica e shpenzimeve për ndërtim janë realizuar në vitin 2003, nga analiza financiare rezulton se ai është në pamundësi mjetesh financiare:

- për vitin 2003 në shumën 47,393 lekë;
- për vitin 2004 në shumën 54,034 lekë;
- për vitet 2005 – 2007 në shumën 1,466,217 lekë.

Apartament banimi në përdorim, i ndodhur në rrugën “B.B”, Tiranë

16. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* përdorimin e këtij apartamenti, bazuar në dy marrëveshje bashkëpunimi, të datave 10.8.2010 dhe 15.2.2016, me shtetasen P.M.

Gjatë hetimit në lidhje me këtë pasuri ka rezultuar se subjekti ka dhënë vendimin nr. ***, datë 30.3.2010, me palë shtetasen P.M.

17. Pas administrimit të vendimit nr. ***, datë 30.3.2010, ka rezultuar se:

i) Në datën 12.3.2010 ka ndërruar jetë i ndjeri A.M. Një fakt i tillë mund të gjendet edhe nga burime të hapura të internetit.

ii) Në datën 30.3.2010, pra 20 ditë më pas, subjekti ka lëshuar dëshminë e trashëgimisë për të ndjerin, vendim që ka marrë formë të prerë më 14.4.2010.

iii) Në datën 10.8.2010, subjekti ka lidhur një marrëveshje bashkëpunimi me trashëgimtaren e të ndjerit, bashkëshorten e tij, sipas së cilës subjekti i ka lënë asaj në përdorim banesën e tij trekatëshe në Shkodër, në këmbim të përdorimit të banesës së saj në Tiranë.

18. Në mënyrë të përsëritur, subjekti hyn në marrëdhënie kontraktuale me palën që ka përfituar nga një dëshmi trashëgimie e lëshuar prej tij në një kohë shumë të shkurtër përpara lidhjes së marrëveshjes.

19. Parë në këtë këndvështrim, nisur nga fakti i një ngjarjeje të përsëritur, unë vlerësoj se subjekti ka cenuar përsëri etikën e sjelljes së një magjistrati. Pavarësisht faktit se çelja e dëshmisë së trashëgimisë ka efekt deklarativ, si dhe nuk ka pasur ankim nga të tretë, duke qenë se është veprim i përsëritur, duket sikur ky subjekt përdor informacionin që merr për shkak të detyrës, për interesa personale.

20. Më tej, nisur nga vlerësimi i provave, rezulton se marrëveshja e bashkëpunimit me znj. M, e vitit 2010, rezulton e lidhur për apartamentin prej 135 m² në rrugën “N.T”. Këtë apartament znj. M e ka blerë në vitin 2006 nga shtetasi B.Th, në vlerën 500,000 lekë. Është më se e qartë që ky çmim nuk përputhet me vlerën reale të pasurisë.

Subjekti ka jetuar në këtë apartament deri në vitin 2016, kur znj. M blen një apartament tjetër në rrugën “B.B”, tek i cili zhvendoset subjekti dhe familja e tij.

21. Ndërkohë, nga dokumentacioni ka rezultuar se në vitin 2011 subjekti ka porositur tek shoqëria “****” një apartament në vlerën 225,342 euro, nëpërmjet aktit noterial nr. ***, datë 19.1.2011.

Subjekti nuk e ka deklaruar këtë fakt as në DPV-në e vitit 2011 dhe as në deklaratën *Vetting*.

22. Si burim për porosinë e këtij apartamenti subjekti ka pretenduar një hua të marrë nga shtetasi Ç.T. Nga analiza financiare e bërë për këtë shtetas ka rezultuar në mungesë mjetesh monetare. Gjatë mbrojtjes së tij, subjekti ka pretenduar të kundërtën, duke sjellë një analizë të kryer për këtë shtetas, nga e cila ai rezulton me mungesë mjetesh monetare në shumën 595,840 lekë. Subjekti e ka quajtur këtë mungesë si të papërfillshme dhe analizën të bërë sipas standardit të Kolegjit.

23. Në këndvështrimin tim, duke qenë se analiza financiare e kryer për huadhënësin bëhet në vija të përgjithshme, pa pasur mundësi detajimi, kjo mungesë e konstatuar tek shtetasi Ç.T., nuk mund të anashkalohet. Në këtë analizë nuk janë përfshirë blerjet e mundshme të pasurive të luajtshme e të paluajtshme, shpenzimet e jetesës apo investime të mundshme të këtij shtetasi dhe, pavarësisht kësaj, huadhënësi është përsëri në mungesë burimesh financiare.

24. Nga ana tjetër, fakti që pasi u tërhoq nga blerja e këtij apartamenti subjekti, huadhënësi e blen këtë apartament, në vlerësimin tim, e gjithë procedura e huamarrjes dhe pastaj tërheqja nga blerja nga ana e z. T janë veprime fiktive me qëllim fshehjen e së vërtetës.

25. Duke vazhduar më tej, në vitin 2016, subjekti lidh një marrëveshje të re bashkëpunimi me znj. M për përdorimin e apartamentit të saj në rrugën “B.B”.

26. Nga vlerësimi i dokumentacionit të administruar rezulton se:

i) Znj. Sh.R., në datën 16.12.2012, ka porositur një apartament tek z. G.R., i cili është i biri, ndërkohë edhe investitor në ndërtimin në rrugën “B.B”, ndërtim që kryhej nga shoqëria “****”¹.

¹ Bëhet fjalë për të njëjtin ndërtim ku subjekti lidhi kontratën e porosisë.

ii) Me kontratë premtim shitjeje të datës 12.8.2013, znj. Sh.R., ia premtion për shitje këtë apartament znj. P.M.

iii) Në datën 25.9.2013, shoqëria “****” ia shet këtë apartament z. G.R.

iv) Në datën 18.11.2015, z. G.R., ia shet apartamentin nënës së tij, znj. Sh.R.

v) Në datën 23.1.2016, znj. Sh.R., ia shet apartamentin znj. P.M.

vi) Në datën 2.12.2017, znj. P.M., ia shet apartamentin shoqërisë ndërtuese “**&*” sh.p.k. Shitësja është përfaqësuar në këtë veprim nga z. D.T., që është vëllai i z. Ç.T.

vii) Në datën 16.1.2018, kjo shoqëri i jep me qira subjektit këtë apartament me sipërfaqe 145 m², ndodhur në rrugën “B.B”, kundrejt vlerës 25,000 lekë/muaj.

27. Më tej, nga hetimi, ka rezultuar se:

i. Nëpërmjet shkresës nr. *** prot., datë 10.5.2022, FSHU-ja ka bërë me dije se kontrata e furnizimit me energji elektrike, me nr. A***, është çelur fillimisht në datën 20.11.2012 nga abonenti Ç.T. Më pas, në datën 19.7.2018, është ndryshuar emri i abonentit², duke kaluar në emër të shoqërisë “**&*” sh.p.k. Nëpërmjet shkresës nr. K*** prot., datë 1.6.2022, UKT-ja ka bërë me dije se kontrata e furnizimit nr. *** është çelur në mars të vitit 2013 në emër të shoqërisë “****” sh.p.k.

ii. Nga analiza e të dhënave të mësipërme dhe nga krahasimi i të dhënave kadastrale³, duket se apartamenti që subjekti ka marrë me qira nga shoqëria “**&*” sh.p.k. në vitin 2018 dhe ai i përdorur nga subjekti edhe më herët, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit me znj. M në vitin 2016, janë e njëjta pasuri. Po ashtu, nisur nga fakti se kontrata e furnizimit me energji elektrike për këtë apartament nga viti 2012 deri në vitin 2018 ka qenë në emër të z. T, e më pas është ndryshuar abonenti, duke kaluar në emër të pronarit të ri, “**&*” sh.p.k., duket se bëhet fjalë gjithashtu për të njëjtin apartament të porositur nga vetë subjekti i rivlerësimit në janar të vitit 2011, për të cilin më pas, në dhjetor të vitit 2011, janë transferuar të drejtat reale në favor të z. Ç.T.

28. Në përfundim, duke analizuar të gjitha këto veprime që lidhen me apartamentin e deklaruar në përdorim nga subjekti, unë çmoj se kemi të bëjmë me veprime fiktive, lëvizje të paarsyeshme dokumentare, të cilat kanë si qëllim fshehjen e gjurmëve të pronësisë reale të kësaj pasurie. Unë vlerësoj se ky apartament është pronësi e fshehur e subjektit.

29. Është e vërtetë ajo që pretendon subjekti se si znj. P.M, ashtu edhe shoqëria “**&*” sh.p.k., kanë mjete financiare të ligjshme për blerjen e pasurisë, por kjo nuk justifikon dot të gjitha veprimet e kryera. Për më tepër që në të gjitha këto veprime dalin emra të personave që janë vazhdimisht prezent në të gjitha veprimet e subjektit, siç është znj. M apo z. T.

² Së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka paraqitur librezat për furnizimin me ujë të pijshëm dhe energji elektrike.

³ Apartament nr. *, me nr. pasurie ***, vol. **, f. **, në z. k. ***, në rrugën “B.B”, shk. *, k. *, Tiranë.

30. Në përfundim, unë konkludoj se subjekti nuk ka arritur të provojë se ky apartament nuk është pasuri e tij e fshehur.

31. Përveç çfarë vlerësoma më sipër, në këtë gjykim timin ndikon edhe fakti se subjekti nuk ka qenë vazhdimisht i sinqertë dhe konsekuent në dhënien e përgjigjeve.

32. Ai ka deklaruar në pyetësorët e bërë nga Komisioni se ka punuar në Tiranë që nga koha e emërimit, viti 2010, por ka jetuar në Shkodër, duke nënkuptuar kështu se e ka bërë përditë vajtje-ardhje nga vendi i punës në atë të banimit. Por i vënë përpara faktit të hetuar nga Komisioni se bashkëshortja e tij ka punuar në Tiranë në këtë periudhë, ndërsa fëmijët e tij ndiqnin shkollën po në Tiranë, ai ka ndërruar deklarin, duke thënë se vetëm ditët e punës rrinte në Tiranë, në fundjavë shkonte në Shkodër dhe këtë e ka konsideruar si qendër të jetës së tij, sepse kishte rrethin familjar e shoqëror atje.

33. E pyetur në seancë në lidhje me këtë konstatim, përfaqësuesja e tij i qëndroi deklarin, duke konsideruar si vendbanim Shkodrën ku shkonte në fundjavë, dhe jo Tiranën ku qëndronte 5 ditë dhe punonte së bashku me bashkëshorten e shkollonte fëmijët.

34. Parë në këtë këndvështrim, unë vlerësoj se subjekti ka kryer deklarin të rremë mbi faktet e pyetura nga Komisioni.

35. Në vlerësimin tim, për këtë subjekt jam përqendruar edhe në mosdeklarin e përdorimit të automjetit tip “Mercedes-Benz”, në pronësi të shtetasit L.A.

Subjekti ka pretenduar se e ka përdorur këtë automjet në mënyrë sporadike, për pasojë nuk ka pasur detyrimin për ta deklaruar.

36. Në këndvështrimin tim, subjekti ka pasur detyrimin për deklarin të këtij automjeti, por edhe të ndonjë mjeti tjetër të përdorur nga ana e tij, për të cilët Komisioni nuk ka arritur të evidentojë ndonjë fakt. Këtu duhet pasur parasysh se subjekti ka jetuar ndërmjet dy qyteteve, Tiranës dhe Shkodrës, që nga viti 2015 dhe, sipas deklarin të tij, çdo fundjavë ka udhëtuar drejt Shkodrës. Por asnjëherë në jetën e tij subjekti nuk ka pasur ndonjë automjet në pronësi. Kjo bën që mungesa e deklarin të përdorimit të automjetit tip “Mercedes-Benz” mund të mos jetë një rast i vetëm. Gjithsesi, për aq prova sa janë administruar, subjekti ka kryer deklarin të pasaktë në deklaratën *Vetting*, duke mos deklaruar përdorimin e automjetit.

37. Një çështje tjetër, për të cilën ndahem nga vlerësimi i shumicës, është ajo e përlogaritjes së shpenzimeve të udhëtimit.

38. Nga sistemi TIMS rezulton se subjekti ka kryer udhëtime të shpeshta jashtë vendit, përkatësisht:

- në vitin 2022 – 4 herë;
- në vitin 2021 – 4 herë;
- në vitin 2020 – 2herë;
- në vitin 2019 – 3 herë;
- në vitin 2018 – 2 herë;

- në vitin 2017 – 8 herë;
- në vitin 2016 – 10 herë;
- në vitin 2015 – 6 herë;
- në vitin 2014 – 8 herë;
- në vitin 2013 – 8 herë;
- në vitin 2012 – 2 herë;
- në vitin 2011 – 7 herë;
- në vitin 2010 – 10 herë;
- në vitin 2009 – 12 herë;
- në vitin 2008 – 11 herë.

39. Në përgjigje të barrës së provës, me qëllim arritjen e një rezultati pozitiv në analizën financiare, subjekti ka pretenduar se ka udhëtuar me shpenzime që janë përballuar nga të tjerë. Ai ka vënë në dispozicion të Komisionit si provë deklarata noteriale të pritësve, duke e konsideruar këtë si provë të plotë.

40. Ndryshe nga shumica, unë mendoj se mund të pranohet vetëm pretendimi i subjektit në rastin e udhëtimit për në Stamboll, tek i vëllai, për në Itali, tek i nipi, si dhe djali i tezes.

41. Në vlerësimin tim, nuk duhet të pranohet pretendimi i subjektit, provuar vetëm me deklaratë noteriale të pritësit, se një mik i tij i ka pritur duke iu prerë biletat e avionit, ka paguar shpenzimet e fjetjes dhe ushqimit për të dhe familjen e tij, si dhe i ka shëtitur në disa shtete, si Austri, Slloveni, Hungari, kur ai vetë jeton në Slloveni.

42. Unë nuk mendoj se duhej pranuar edhe pretendimi tjetër se një mik tjetër me banim në Londër i ka organizuar udhëtimin në Londër në vitin 2010, për më tepër që udhëtimi ishte në vitet 2011 dhe 2018.

43. Në këndvështrimin tim, nuk mund të pranohet se subjekti ka udhëtuar vazhdimisht, shpesh me familjen e tij, me shpenzimet e të tjerëve. Kjo mbështetet edhe në faktin se këto udhëtime të paguara nga të tjerë nuk janë deklaruar asnjëherë në DPV-të periodike, si dhurata apo trajtim preferencial, siç parashikohet në ligj.

44. Subjekti nuk ka dhënë shpjegime për këto udhëtime as në pyetëtorin standard dhe as në pyetësorët e bërë gjatë hetimit administrativ, duke pretenduar se nuk mbante mend. Vetëm në përgjigje të barrës së provës, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, ai ka depozituar shpjegime, por duke mos dokumentuar/provuar vendqëndrimin dhe aftësitë financiare të pritësve të tij. Në përputhje me standardin e vendosur nga Kolegji, këto pretendime të subjektit nuk mund të merren në konsideratë.

45. Duke mos pranuar këto pretendime të subjektit mbi shpenzimet e udhëtimit, ndryshon edhe rezultati i analizës financiare.

46. Në përfundim të vlerësimit, duke pasqyruar të gjitha sa u tha më sipër në lidhje me shpërndarjen e shpenzimit për ndërtimin e shtëpisë trekatëshe në Shkodër, si dhe shpenzimet e udhëtimit, subjekti rezulton se:

i) Nëse merret në konsideratë shpërndarja e shpenzimeve për ndërtimin e shtëpisë në Shkodër, sipas pretendimit të subjektit, sipas të cilave shumica e tyre janë kryer në vitin 2003, ai do të rezultonte me pamundësi financiare për periudhën 2003 – 2016, në shumën 3,668,442 lekë.

ii) Nëse shpërndarja e këtyre shpenzimeve do të bëhej në mënyrë proporcionale për periudhën e ndërtimit të katit të parë dhe të dytë gjatë periudhës gusht 2003 – dhjetor 2004, ai do të rezultonte në pamundësi mjeteshe financiare për periudhën 2003 – 2016, në shumën 4,868,152 lekë.

47. Përveç çfarë kam vlerësuar deri tani, në raport me pasurinë e subjektit, një çështje tjetër që duhet marrë në shqyrtim është edhe çështja e të pandehurit V.C.

Në këndvështrimin tim, subjekti ka dështuar të provojë të kundërtën e barrës së provës.

48. Në vendimin gjyqësor nr. **, datë 24.1.2005, trupi gjykues arsyeton se i pandehuri V. C., është përgjegjës për veprën penale “vrasje në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme”, të parashikuar nga neni 83 i Kodit Penal, pasi ai ishte nën kërcënimin e një sulmi të drejtpërdrejtë, të rrezikshëm për jetën, por i është kundërpërgjigjur këtij sulmi kur ky ishte ndërprerë dhe nuk kishte më intensitet. Pretendimet e organit të akuzës se jemi para veprës penale “vrasje me paramendim për motive gjakmarrjeje”, nuk qëndron, pasi nuk u provua gjatë gjykimit. Gjithashtu, sipas trupit gjykues, vrasja për gjakmarrje bëhet në emër të zakoneve dhe kanunit dhe si rregull vihet në dijeni e gjithë familja e personit që do të kryejë krimin (që do të marrë gjak) dhe, në të tilla raste, autori shoqërohet me një pjesëtar të afërm të familjes, ndërsa pjesëtarët e tjerë ruhen. Në rastin në fjalë, pjesëtarët e familjes së të pandehurit nuk kanë pasur dijeni për ngjarjen. Gjykata është e bindur se viktima ka sulmuar i pari dhe se sulmi mund të ketë pasur për bazë frikën kundrejt të pandehurit. Gjykata çmon se i pandehuri është i pafajshëm për veprën penale “armëmbajtje pa leje”, pasi nuk u provua që ai të ketë pasur armë tjetër, veç armës që mbante me leje të organeve kompetente.

49. Në këto kushte, trupi gjykues ka vendosur:

Në bazë të nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, nga vepra penale “vrasje me paramendim” në veprën penale “vrasje në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme” dhe dënimin e shtetasin V. C., me 3 (tre) vjet burgim.

i. Në dosjen gjyqësore gjendet:

- Akt ekspertimi mjekoligjor nr. **, datë 6.6.2003, nga ku rezulton se tek viktima ka dy plagë të shkaktuara me armë zjarri.
- Akt ekspertimi nr. ***, datë 12.8.2003, sipas të cilit fishekët e gjetur në vendngjarje nuk janë qitur nga arma tip “TT”, mod. **, kal. ** mm, e cila i është sekuestruar z. V.C.
- Procesverbal për deklarimin e personit që tregon rrethanat e hetimit, datë 12.8.2003, në të cilin shtetasi M.K ka deklaruar: “...V ka dalë nga dera e parë e pasagjerit me pistoletë në dorë dhe ka qëlluar mbi V. Kam parë që edhe V ka qëlluar me pistoletë ndaj V...”
- Procesverbal për deklarimin e personit që tregon rrethanat e hetimit, datë 7.6.2003, në të cilin shtetasi M.K ka deklaruar: “...pasi i kaluam pallatet na del përpara një makinë tip Benz ** me ngjyrë të bardhë, në të cilin ndodheshin dy persona. Sapo po ndërroheshim me veturën tip

Benz në drejtimin tonë qëlluan me armë, personi që qëlloi me armë zbriti nga makina dhe qëlloi në drejtimin tonë dhe hipi përsëri në makinë dhe u largua në drejtim të Urës së Thive ...personi që qëlloi në drejtimin tonë ishte afërsisht 1.70 m i gjatë, i shëndoshë, kishte një kapelë në kokë dhe flokët i kishte në ngjyrë të zezë, kishte veshur një kostum sportiv”.

50. Ky shtetas ndërkohë ka ndryshuar deklaram, duke deklaruar ndryshe përpara gjykatës kur është kërkuar sigurimi i provës, duke u dënuar më pas me vendimin nr. **, datë 29.9.2003, për veprën penale “dëshmi e rremë dhënë para gjykatës”.

- Procesverbal për deklarimin e personit që tregon rrethanat e hetimit, datë 7.6.2003, në të cilin shtetasi A.A ka deklaruar: “...dëgjoj disa krisma dhe pashë një person ra në tokë dhe një makinë Benz i bardhë u largua në drejtim të Urës së Thive. Personi që ndodhej në sediljen e pasme të veturës ishte me flokë të shkurtra me ngjyrë të zezë ...kam parë që në momentin që është qëlluar në drejtim të V, prapa tij ndodhej një person me motor papaq”.
- Procesverbal për deklarimin e personit që tregon rrethanat e hetimit, datë 13.6.2003, në të cilin shtetasi K.D deklaroi: “...Nga dita e shtunë ne si familje nuk jemi interesuar se kush na ka vrarë djalin tonë, duke menduar se dikush sipas zakonisht do të na çonin ndonjë fjalë përpara varrimit... Pikërisht ditën e diel në shtëpi të V(viktimit) kanë ardhur tre persona... sipas zakonisht, M.N., na ka thënë “Burra, kam një fjalë për t’ju thënë, kemi ardhur në emër të N.P.C për t’ju thënë djalin tuaj jua kemi vrarë ne... mos kërkonit tjetërkund...”

ii. Gjykata argumenton si më poshtë në vendim:

“I pandehuri, i cili është përkulur për t’u mbrojtur poshtë kroskotit të makinës, kur kupton se V nuk kishte më fishekë, kundërvepron nga vetura duke qëlluar në drejtim të V me armën e tij të brezit pistoletë, të cilën e kishte si armatim personal, pasi ishte polic dhe nga ky kundërveprim V merr një goditje në gjoks...”

Në të tilla rrethana, gjykata çmon se i pandehuri V.C është përgjegjës për veprën penale “vrasje në kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme”, të parashikuar nga neni 83 i Kodit Penal, pasi ishte nën kërcënimin e një sulmi të drejtpërdrejtë, të rrezikshëm për jetën, por i është kundërpërgjigjur këtij sulmi kur ky ishte ndërprerë dhe nuk kishte intensitet.

Gjykata çmon se i pandehuri V.C është i pafajshëm për veprën penale “armëmbajtje pa leje”, të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal. Nga provat e marra e të administruara, rezulton e provuar se i pandehuri është kundërpërgjigjur me armë, por nuk provohet se i pandehuri ka pasur armë tjetër...”

51. Nga analizimi i fashikullit gjyqësor dhe vendimit të gjykatës, konstatohet se:

- i. Gjykata është kontradiktore në argumentimin e saj, pasi fillimisht deklaroi se i pandehuri ka përdorur armën e brezit (duke mos marrë në konsideratë aktin e ekspertimit, sipas të cilit gëzhhojat e gjetura në vendngjarje nuk i përkisnin armës së brezit të pandehurit) dhe më pas deklaroi se nga provat e marra nuk provohet se i pandehuri të ketë pasur armë tjetër.

- ii. Nga dinamika e ngjarjes rezulton se nuk jemi në kushtet e kapërcimit të mbrojtjes së nevojshme, pasi nga provat e administruara nuk provohet që viktima të ketë kryer sulm ndaj të pandehurit, duke marrë në konsideratë edhe faktin se në vendngjarje nuk është gjetur armë. Por, edhe sikur viktima të kishte sulmuar të pandehurin, bazuar në pjesën argumentuese të gjykatës sulmi kishte përfunduar, për rrjedhojë lidhja shkakësore për të qenë në kushtet e kapërcimit të mbrojtjes së nevojshme nuk plotësohet. I pandehuri nuk ka kundërvepruar në momentin e sulmit, por pas përfundimit të sulmit. Që të ishim në kushtet e kapërcimit të mbrojtjes së nevojshme duhej që i pandehur të ishte ende nën kërcënimin e një sulmi të drejtpërdrejtë dhe të rrezikshme dhe të përdorte mjete apo mënyrë mbrojtje që nuk përputhje me intensitetin e sulmit.
- iii. Në pjesën arsyetuese të vendimit mungon argumentimi i konkluzionit që veprimet e të pandehurit plotësojnë elementet e veprës penale të “kapërcimit të mbrojtjes së nevojshme”, si dhe analizimi i këtyre elementeve, qoftë edhe në formë të shkurtuar. Gjykata nuk analizon faktin se nga ana e të pandehurit, pa qenë në kushtet e një sulmi të drejtpërdrejtë të çastit, është përdorur armë zjarri duke qëlluar mbi viktimën.
- iv. Gjithashtu mungon argumentimi i konkluzionit që veprimet e të pandehurit nuk plotësojnë elementet e veprës penale “armëmbajtje pa leje”, si dhe analizimi i këtyre elementeve, qoftë edhe në formë të shkurtuar. Gjykata nuk analizon faktin se i pandehuri, pa qenë në detyrë, ka përdorur armë, qoftë kjo armë edhe me leje për shkak të detyrës.

52. Nga sa më sipër, vlerësoj se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk është i argumentuar, për rrjedhojë ngrihen dyshime për favorizimin e të pandehurit V.C.

53. Në përfundim, për këtë subjekt, unë, komisionerja e mbetur në pakicë, vlerësoj se:

- i) Subjekti është përpjekur të fshehë pasurinë nëpërmjet veprimeve fiktive.
- ii) Subjekti ka qenë i pasaktë në deklaratën *Vetting*, duke mos deklaruar përdorimin e të paktën një automjeti.
- iii) Subjekti është në kushtet e pamundësisë financiare, në vlerën 3,668,442 lekë.
- iv) Subjekti në mënyrë të përsëritur ka shkelur etikën e magjistratit.
- v) Subjekti ka reflektuar arsyetim të dobët të paktën në një çështje, ku duket se ka favorizuar të pandehurin.

54. Për të gjitha këto, vlerësoj se subjekti jo vetëm që është në kushtet e nenit 61, pika 3, në lidhje me kriterin e pasurisë, por me të gjitha veprimet/mosveprimet e tij ai ka cenuar besimin e publikut tek drejtësia, duke plotësuar kriteret e nenit 61/5.

55. Për këto arsye, kam votuar për shkarkimin nga detyra të subjektit Besnik Hoxha.

Genta Tafa (BUNGO)
Anëtare (kundër)

